

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

D E V I S

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K31420012M

NUIS/NIPT

Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga Siri Kodra, Magazina nr.10 kati 1, në Zonën Kadastrale 8330, Nr.Pasu
Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672009907

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

kristileka@gmail.com

E-mail

Administrator Kristinka Leka

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/10/16

Data (viti/muaji/dita)

0672009907

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-77870-08-18-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Tjetër

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

51224000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/09/20

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2023/09/20

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-77870-08-18-2023

42716000-8

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

1. Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,
 2. VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,
-

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmëri)

- Tjetër

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Në faqen zyrtare të Agjensisë së Prokurimit Publik është zhvilluar procedura e prokurimit publik, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar “Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier” me Autoritet Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara,.

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi ishte data 20.09.2023.

OE ankimues DEVIS shpk, është njoftuar nëpërmjet mesazhit elektronik me datë 09.10.2023 për anulimin e procedurës së prokurimit.

Më pas, me datë 16.06.2023 në Buletinin e Njoftimeve Publik Nr. 86, është kryer publikimi i vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit me motivacionin: në zbatim të pikës c), të nenit 98 të Ligjit Nr.162/2020 ku përcaktohet se “konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme

Duke e gjetur vendimin e Autoritetit Kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit në kundërshtim me ligjin paraqesim këtë ankesë, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 109 të LPP?së përse më poshtë vijon.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Së pari sqarojmë se akti/veprimi administrativ i kryer nga ana e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit është i paargumentuar.

Në ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 98 të tij është parashikuar:

Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
 - b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
 - d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.

Ndërsa në VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar në nenin 38 të tij parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.

2. Njoftimi i anulimit duhet të përmbajë të paktën:

emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;

numrin e referencës së procedurës;

objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);

emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;

arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.

Gjithashtu ky akt/vendim është nxjerr në kundërshtim edhe me kërkesat e neneve 99 dhe 100 të Kodit të Procedurave Administrative:

Neni 99

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij. 2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;

ii) palët të cilave u drejtohet akti;

iii) datën e miratimit;

iv) bazën ligjore;

b) pjesën arsyetuese;

c) dispozitivin që tregon:

i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit; iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjal. 4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 100

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar.

Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;

b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;

- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Në këtë akt mungon pjesa arsyetuese mbi të cilën është nxjerrë akti, shpjegimet e rezultatit të vendimit administrativ dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij zbatohen në rastin konkret, cka provon se ky akt/vendim është i paarsyetuar (një ndër parimet bazë të aktit administrativ) dhe duhet të deklarohet i pavlefshëm pasi cenon interesat e ligjshme të operatorëve ekonomik pjesmarrës dhe vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit si të LPP-së dhe të K.Pr.Adm..

Në nenin 75 të VKM-së “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet:

1 Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit.

2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.

Në do rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Përjashtimisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t’i propozojë titullarit anulimin e procedurës.

Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Në referim të dispozitës së mësipërme, ligjvënësi ju ka njohur të drejtën Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për të anuluar një procedurë prokurimi por vetëm në cdo rast KVO duhet të vlerësojë dhe argumentojë se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me ligjin.

Akti administrativ kërkon patjetër ekzistencën e disa elementeve të rëndësishme, me të cilët duhet të paraqitet, mungesa e të cilave mund ta bëjnë atë pa efekt juridik.

Pra ligji ka vendosur se duhet të plotësohet të dy kushtet kumulative që të anulohet procedura e prokurimit.

- a) Vlerësimi i KVO-së
- b) Argumentimi se kush kriter bie ndesh me ligjin material ose ligjin e fushës përkatëse.

Në çdo akt administrativ elementet thelbësore, që nënkuptojnë si përmbajtjen edhe formën e tij, janë autoritetësia e aktit, përshkrimi i lëndës dhe i subjekteve që u drejtohet, arsyetimi dhe dispozitivi. Përmbajtja e aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe i përcaktuar mirë. Këto elemente të formës dhe përmbajtjes së një akti administrativ janë tepër të rëndësishme dhe nuk

mund të injorohen. Ato konsiderohen pjesë përbërëse e vet aktit dhe mosrespektimi ose moszbatimi i tyre mund të ndikoj drejtpërdrejt në rregullsinë dhe në vlefshmërinë e tij. Arsyetimi i aktit/vendimit duhet të përfshijë faktet thelbësore, boshtin logjik dhe bazat ligjore që ka pasur parasysh autoriteti kontraktor. Nëpërmjet arsytimit të aktit qartësohet qëllimi që ka patur organi administrativ në vendimarrje. Arsyetimi përbën një element thelbësor të formës dhe përmbajtjes së aktit/veprimit administrativ dhe ndikon drejtpërdrejt në vlefshmërinë e tij. Sipas nenit 108, shkronja “iii” të Kodit të Procedurave Administrative, mosrespektimi i formës dhe elementëve së caktuar nga ligji është shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit.. Kështu, duhet të arsyetohen të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë ose prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat dhe interesat e ligjshëm të subjekteve të cilëve u drejtohen.

Në rastin konkret mungojnë elementë të formës dhe përmbajtjes së aktit administrativ e për rrjedhojë akti administrativ është i pavlefshëm.

Së dyti, cmojmë se të gjitha kriteret kualifikuese janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kjo procedurë prokurimi është një procedurë e rishpallur nga ana e autoritetit kontraktor dhe në procedurën e mëparshme (REF-40205-08-30-2022.) me po të njëjtat kriteret kualifikuese po ky autoritet kontraktor vendosi anulimin e procedurës së prokurimit me motivacionin se nuk kishte asnjë ofertë të vlerfshme,

Kjo procedurë e mëparshme prokurimi, ju nënshtua dhe hetimit administrativ nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik i cili me vendimin Nr. 322/2023

Sa më sipër, nëpërmjet veprimi të tij, autoriteti kontraktor po cënon dhe parimin e sigurisë juridike.

Parimi i sigurisë juridike presupozon, vec te tjerash besueshmërinë e qytetarit tek shteti dhe pandryshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cënojnë jetën e tij dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të tjera të mëparshme (shih dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.37/2012, nr. 31 dt. 18.06.2010, nr. 24 datë 12.11.2009, nr. 9 datë 26.02.2007).

Përsa më sipër shpjeguar, kërkojmë:

Anullimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

kristileka@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Kristinka Leka